



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Rep.	2-D/DPK
Faq. Uranica Mues	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-1914/14
Data Datum Date	28.05.2014
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 27.05.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-3289/13, për znj. Fikrije Fejzullahu – Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, për shkak se zyrtarja e lartë publike ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i Hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Fikrije Fejzullahu – Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznesi privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtarja e lartë znj. Fejzullahu është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtimin e funksionit, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme si Prokurore i Shtetit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “Avokate Fikrije Krasniqi - Fejzullahu”.

Zyrtarja i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit. Pas pranimit të kësaj shkresë znj. Fejzullahu, është këshilluar që të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat, në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, për të parandaluar gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë znj. Fejzullahu është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet, ajo ka deklaruar se është e ç' regjistruar nga lista e Avokatëve në Oden e Avokatëve të Kosovës dhe nuk e ushtron funksionin e Avokates, që nga koha e emërimit në funksionin publik si Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, prandaj ka premtuar se menjëherë do të fillojë procedurën për mbyllje të biznesit privat.

Duke parë se procesi i ndryshimeve po zgjatë Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet "njoftimi paralajmërues", me të cilin zyrtares së lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Zyrtarja e lartë znj. Fejzullahu ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 1787/14) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja e biznesit privat "Avokate Fikrije Krasniqi - Fejzullahu".

II. Në mbështetje të nenit 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

